

Fejzë Demiri

QIRINJ PËR DRITË

poezi

Fejzë Demiri

poezi

Botues

SAS

Redaktor

Sabit Jaha

Recensent

Islam Rahimi

Korrektor letrar

Bardh Guri

Kopertina

Endrit Aliu

Nuk është veçse të pëlqeja

Të kam dashur shpirtërisht nga brendia e shpirtit

Të kam ndjerë në çdo çast a rrahje akrepash

Të kam veçuar si më e veçanta e veçantisë

Edhe atëherë kur me buzëqeshje më flisje, kur më urreje

Unë kam qenë i njëjti me ty

T'i kam dashur kohërat

Errësirën jam munduar të ta bëj dritë

T'i kam dashur hapat kur i ndërroje në rrugët me asfalt a kube

Edhe kur sa e sa të tjerë më buzëqeshnin

Asnjëherë, për asnjë moment,

Nuk kam dashur më shumë se buzëqeshjen tënde

E di që shpesh ndoshta t'u kam bërë i tepërt

Të kam mërzitur, ndoshta t'u kam bërë edhe nevrik

Ama të betohem që të kam ndjerë në çdo ind, palcë mbi kurriz

Ti ke qenë për mua drita e diellit që ngroh dhe dritëson "qiellin tim"

Edhe kur nuk të kisha pranë

Ti ke qenë prezent gjithmonë në ndjenjat dhe rrugëtimet e mia

Kisha nevojë për ty, jam ndjerë plagëhapur e i pakuruar

Përgjithmonë e memorizuar në kujtesë.

Loti

Sa rrëpishëm pikon loti

Të zhytur thellë të bën si qenie

Edhe zemrës i vjen gjynah për lotin

Ashtu si lotit që i vjen për zemrën.

Qirinj për dritë

Sa qirinj janë ndezur

Për të larguar këtë terr

Ama nuk e kam ditur

Që terri shuaka të gjithë qirinjtë.

Në këtë natë

Në këtë natë të acartë

Ku ftohti ka mpirë gjakun

Dëshiroj të jesh ti

Ti zjarri im

Që shkrin këtë acar

I përjetshëm

Unë hija jote.

Mos lejo

Do të doja e dashur

Të tretëm tek ti

Si një fletë letreje

Kujtimi

Aman mos lejo

Që fleta të griset.

E paharruar

Si mund të të harroj e dashur

Kur nuk më lejon kujtimi

Si të mos i shfaq ndjenjat

Kur më brengos tundimi

Si të të flas, kur heshtja ndaluaka fjalët

Si t'i fsheh lotët

Kur rrjedhin përmallshëm

Nuk mund t'i fsheh kohërat

Se ato lënkën gjurmët

Nuk mund të mos mendoj për ty

Kur rreth teje sillet mendimi

Ti je diell për mua

Që hënës i jep ndriçimin.

Pa ty

Sa shumë do të doja e dashur

Të të kem sonte...

Të ngrenim bashkë dolli

Të flisnim, të çmalleshim, të qanim

Për netët që lotueshëm na ndanin

Në këtë natë pa gjumë

Kur edhe qielli ka marrë nuanca zyrtësie

Do të doja të t'i puth sytë

Të të përkëdhel e të marrë në gji

Sikurse nëna që bën për fëmijën

Kur të kem afër e dashur

Edhe qielli hapet e merr shkëlqimin

Dielli me dritëhijet a rrezengrohtësinë

Vezullon qiej

Duke mbuluar rruzullimin.

PORTA E ZEMRËS

Jeta

Si një taketuke cigareje

Para saj shkunden shpirtrat

Në gjumin e përjetshëm.

Porta e zemrës

Kurdo që e ndien veten të vetmuar

Mund të hapësh portën e zemrës sime

Aty ende ka vend për hyrjedaljet.

Para se ...

Para se t'i puthë buzët

T'i kam puthur fjalët

Para se t'i puthë flokët

Ta kam puthur shpirtin

T'i kam puthur kohërat

T'i kam dashur buzëqeshjet,

Buzëmbërënjeve...

Ta kam puthur lotin

Ta kam dashuruar qenien

Deri në ekstazë...

Dashuria

A e ke pa ç'bën dashuria?

Shkrin edhe akuj të tërë

Sa ftohtësi largon nga brenda

Edhe dimrin e bën verë.

Dhembje kohe

Sa keq që dhembjen nuk mund ta përshkruajnë fjalët

Sa keq që fjalët nuk përshkruajnë dhembjen.

Më vjen inat

Më vjen inat

Kur buzëqeshja jote

Del si vegim, më fanitet

E vetmja buzëqeshje që më plotëson

Në këtë kaos dhimbjesh.

Unë, imazhi yt

Si një gotë e mbushur

Jam shterur

I etur

Që nuk kam çfarë të pi

Në gotë jam shkrirë

Unë, imazhi yt.

Më ka marrë malli

Më ka marrë malli

Për agimet e hershme të fëmijëve fytyrëqeshur

E të pleqve të krekosur, plot rrudha kohe e përjetime

Sinqeriteti i tyre kapërcen kufijtë e të sotmes

Ah! Sa dembel që jemi bërë

Në këtë kohë pa kohë

Ku interesi e lakmia na kapërdu kohërat moderne.

Unë, hiri yt

Si një gacë

E ndezur

Më shndërrove

Në tym

E nga tymi mbeta veç hi

Përgjithmonë do të jem

Unë, hiri yt.

Më duaj

Më duaj e dashur

Edhe kur të gjithë të m'i fikin dritat

E nuk shoh për të dalë

Nga ky labirint shtigjesh

Më duaj

Edhe kur më quajnë qaraman

Njeri të pështirë a “buburrec” të dërmuar

Unë e kam shpresëplot

Tek ti

Që t'më nxirrje nga ky hon terratisjesh e stërmundimesh.

Puthje e ëmbël

Si qershitë në fillimverë

Që ëmbëlzojnë në pikë të vapës

Edhe zjarri i puthjes tënde

Në pikë të dimrit më sjell vapën.

Isha

Isha shekull

U bëra dekadë

Vit

Muaj

Javë

Por, më së tepërmi, po më merr malli

Për një çast.

LOT I SHIUT

Lot i shiut

Isha lot i shiut

Shiu u bë lumë

E lumi det

Po aty

Ku unë ruaj kujtimet.

Buzët e tua

Sa do të doja t'i kem

Buzët e tua të mishta

Po aq edhe të ëmbla

Të vetmet që larguakan

Këtë vuajtje dhembjemadhe.

Gacë e ndezur

Cigarja djeg buzët

Kur e prek gacën e ndezur

Ashtu është dhe dashuria

Kjo flakëkuqe që përvëlton shpirtin.

Kohezion dashurie

E dashur

Më prit të të vij një ditë

Si molekulë grimcash

Më prit

Të bëhemi bashkë në këtë kohezion dashurie.

Kohë e mërdhirë

Kur ta kuptosh që ndihesh i vetëm

I përbuzur në kohë t'mërdhirë

Një gjë duhet ta mbash në mend;

Mbështillu me palltën e dashurisë.

Qielli im i yjëzuar

Kur të pashë ty yjësi

U mbusha me yje

Yjëzuakan dritat

Në këtë yjëzim dritërrezatues

Yjëzon, ti qielli im i yjëzuar.

Më lë pa frymë

Dritëdhënëse që i jep dritë

Dritëgjatësisë sime

Dritëplotë që më plotëson

Në këtë errësi të zjarndeze e të zymtë

Kohërash drithërimë

Dritëlargësi e ndjeshme që më lë pa frymë.

Parfumi i dashurisë

Nëse mendon që të kam harruar

Dashuria thua s'ka mbirë

Eja shiko në sirtarin tim

Aty mbaj parfumin e dashurisë.

DO TË DUHEMI

Do të duhemi

Të kam dashur kur sythat e luleve çelnin

Në agimet e hershme pranverore

Gjelbërim të tejshkuar

Të kam dashur kur qielli ngrysej

Retë sillnin shiun e rrëpishëm

E ne shkelnim piklave të tij

Të kam dashur edhe atëherë kur gjethet vjeshtarake binin

Kur dielli vjeshtarak piqte mollë, ftonj e misër

Do të dua edhe në kohët e acarta, kur veriu mërdhin

Kur akulli të bëhet pasqyrë rrëshqitëse në pullazet e shtëpive

Ne prapë do të duhemi...

Kaçurrelja

Si rrezedielli që shkriu dëborën

Në këtë mesditë të fillimdimrit

Kaçurrelja sykuqrrremtë

Lulon si lule trëndafili

Sytë e saj shikimprehtë

Hapën kupë, hapësirë të qiellit

Qerpikgjata, fytyrëqeshur

Diellzonte edhe për diellin.

Kostum kohe

Edhe atëherë kur t'i kem të gjitha

Njeri i harlisur në pasuri

Do të doja të vishja kostumin tënd kohë

A ka diçka më të shtrenjtë se ti?!

Pambarim kohe

Po të kthehej koha pas

Në një pikë që unë kisha dashur

Nuk do ta lëja kohën nga këtu të ikën

Do të rifilloja prapë me ty

E do të vazhdoja deri në pambarim

E kur koha të përfundonte

Do të thoja: ende s'jam ngopur, unë me ty!

Për ty

Për ty

Do t'i fikja të gjitha dritat

E do të qëndroja në errësirë

Do të fikja edhe qiriun e fundit, flakëndezur

Shpirtrash

Se më as drita s'do të ketë kuptim pa ty

Kryevepër

Nëse jeta do të më pasuronte

Në një kohë tjetër

Ti prapë do të kishe lënë gjurmë tek unë

Si shkronjat mbi këtë letër

Po nëse do të ikje nga unë

Kujtimi për ty do të kishte mbetur

Si një kryevepër.

Të pres

Nëse një ditë do të vish shkujdesur

Me hapat e padukshëm të kohës regëtimë

Të pres, takohemi tek vendi

Aty, ku i çmenduri mund çmendurinë.

Cigare e fikur

Me lot në sy zjarri i than lotët

Duke ndezur cigaren

Mundohem që ta pi,

Por nga buzët që dridhen

Nuk më lë dot të ngopem me tymin e tij,

Unë i shkreti mendova ta ndez, ta ndaloj këtë mërzi

Por loti më ndali e fiku gacën, si një pikë shi.

ËNDËRR E PAARRITSHME

Zjarrdashësi yt

Kur ti vetë u bëre

Zjarrndezëse për mua

Atëherë si të mos bëhem unë

Zjarrdashës për ty.

Kujtim i pashlyer

Nëse më pyet: pse s'të kam?

Përgjigjen te vetvetja e ke

Fillo me mendjen të flasësh

E kohën pyete përse

Ajo njerëzit edhe mund t'i harrojë

Ama kujtimet nuk i zbeh.

Sa për çudi

Sa për çudi është jeta

Vera më solli të ftohtin

Loti e ndali dhe shiun

Shiu largoi dëborën

E zemrën e ngrirë

S'e shkriu.

Kur fillova të qaj

Kur fillova të qaj

Vetja më tha qesh

Qesh e mos u zgërdhi

Fillova të hesht, heshtjen ma ndaluan fjalët

E fjalës i tha mendja

Rimendo para se të flasësh.

Kur e kupton

Kur e kupton që nuk ke ecur me kohën
Shpesh je bërë dorë e gishtërinjve të huaj
Kanë luajtuar me ty, të kanë sharë, përbuzur a lajkatur
E ti prapë ke qenë i njëjti
Si në përqaftime a përbuzje
Edhe atëherë kur të kanë pështyrë pas shpine
E koha luante symbyllas
Të ardhmen, ëndrrat t'i patën vënë në krahët e lejlekëve
E ti prapë nuk u brengose miku im
Ishe i drejtë në kohën e padrejtësisë.

Do të vij

Do të vij një ditë

Lotët të t'i heqë

Do të bëhem buzëqeshja jote

Edhe pse s'do të jem me ty

Do të jem në hapat e tu

Më lejo të lutem

Gjumi yt të bëhem.

Pa fjalë

Do të takohemi sërish

Netëve nuk do t'u besojmë si më parë

Mërzinë do ta ngulfasim në shishe

E kohës le t'i kthehemi pa fjalë.

Dritë e verbër

Nuk është errësira

Që nuk më la për të parë

Është drita ajo

Që m'i verboi sytë.

Ëndërr e paarritshme

Nëse, qoftë...

Edhe një herë të vetme

Të paraqitem në ëndërr

Edhe ëndrën zgjoje

Nga gjumi!

SHËNIME PËR AUTORIN

Fejzë Demiri u lind më 15 janar 1997 në Stubëll të Gjakovës. Shkollimin fillor e ka kryer në Berjahë, në Gjakovë Shkollën e Mesme Profesionale “Gjon N. Kazazi”, drejtimi gjimnaz-shkenca natyrore. Tash studion në Kolegjin “FAMA”, drejtimi Psikologji e përgjithshme, në Prishtinë.

Deri më tash botoi këto vepra:

1. *Vargje përkushtuese I*, poezi, Gjakovë, 2012
2. *Vargje përkushtuese II*, poezi, Gjakovë, 2014
3. *Në detin e dashurisë e të thënies* (fjalë të urta dhe mendime autoriale), botoi ATUNIS, Prishtinë, 2016
4. *Kur shpirti ka etje*, botoi FISHTA, Prishtinë, 2016
5. *Qirinj për dritë*, SHB “SAS”, Prishtinë, 2017.

Fjala e redaktorit

VEPËR ME LAJTMOTIV PËR DASHURINË

(Fejzë Demiri “QIRINJ PËR DRITË” (poezi) botoi SHB “SAS”, Prishtinë, 2017)

Pas katër veprave letrare, kryesisht me poezi për të rritur Fejzë Demiri para lexuesve sivjet (2017) sërish paraqitet me veprën e pestë letrare me titull “QIRINJ PËR DRITË”, botuar nga SHB “SAS”. Me këtë autori i ri, por me një përvojë krijuese brendapërbrenda pesë vitesh, para lexuesve - artdashësve letrarë, nga libri tek libri tjetër gjithnjë e më shumë e më bindshëm po e dëshmon përkushtimin e tij prej krijuesi, i cili jep të kuptohet se vokacioni i tij letrar po merr përmasa më të mëdha në këtë fushë veprimi. Përmbledhja e poezive “QIRINJ PËR DRITË” është strukturuar në pesë cikle: “QIRINJ PËR DRITË”, “LOT I SHIUT”, “DO TË DUHEMI” dhe “ËNDËRR E PAARRITSHME”, të cilëve iu paraprin poezia “NUK ËSHTË VEÇSE TË PËLQEJA”, që d.m.th. vepra në fjalë është sajuar nga 44 poezi që për lajtmotiv ka për temë – dashurinë – virtytin më të lartë dhe më të çiltër të të rinjve, komunitetit të të cilit i përket edhe autori i librit, i cili tashmë veçsa i ka mbushur të njëzetat.

II

Poezia “NUK ËSHTË VEÇSE TË PËLQEJA” është pararendësja, një si udhërrëfyese, e cila e përgatit lexuesin që të hyjë në botën intime të poetit të ri, i cili me “qirinj” përgatitet të bëjë dritë, për të trazuar rrugëtimin nëpër të cilin “udhëton” ai për të gjetur njeriun – të dashurën (ndoshta atë kaçurrelen, së cilës ia kushton pothuajse të gjitha poezitë e tij). Me këtë rast, sikur lexuesi tashmë e njeh dhe e ndjen poetin e ri, i cili me qirinjtë e ndezur për dritë – duke kërkuar njeriun- të dashurën... vepron ashtu siç pandehte dikur Diogjeni me fener të ndezur në pikëditë, duke kërkuar Njeriun, të cilin sikur nuk e gjente dhe vetëm e kërkonte pareshtur..., por poeti Fejzë Demiri Njeriun – Të Dashurën (ndoshta Kaçurrelen...) nuk e kërkon ngase e njeh, e ndjen kudo dhe kurdo në të gjitha kohët, vendet, çastet e jetës, me të cilën ditën apo natën, afër apo larg, sot apo nesër, në gëzime apo në hidhërime, në suksese apo në dështime, në rezultate apo synime është Ai dhe Ajo, që së bashku janë Një.

III

Në ciklin e parë “QIRINJ PËR DRITË” janë përmbledhur gjashtë poezi, ku gjejmë lotin, qirinjtë, natën si dhe të bëmat e jetës së trazuar të një të riut për të dashurën e tij që nuk ka gjumë, që është i shqetësuar, që është në gjendje të bëjë gjithçka me qëllim për të arritur t’i

realizojë synimet e tij të sinqerta. Në ciklin e dytë “Porta e zemrës” janë përmbledhur 12 poezi, ku poeti duke dhënë pasqyrën e jetës ai hap portën e zemrës për hyrjedaljet e saj për dashurinë, për dhembjet e kohës, për imazhin, për hirin, për puthjet e për çka jo tjetër. Në ciklin e tretë “LOT I SHIUT” janë strukturuar tetë poezi, ku poeti sajon vargjet me lot shiu, ku shpërfaqen buzët e së dashurës, ku ato janë si gaca zjarri, me atë kohezion të dashurisë, në një kohë të mërdhirë, ku qielli është i yjzuar, ku njeriu mbetet si pa frymë nga parfumi i dashurisë.

IV

Në ciklin e katërt “DO TË DUHEMI” poeti në tetë poezi e tij del sheshit dhe sikur e shfaq të dashurën e tij – Kaçurrelen – atë kryeveprën e vet, ndaj së cilës shpreh intimitetin me fjalët bindëse dhe premtuese, duke pohuar haptas se “Do të duhemi”, duke iu drejtuar Kaçurreles (...) të cilën në pambarim kohe e njeh dhe e ndjen me çiltërinë dhe pastërtinë shpirtërore, meqë atë (...) e quan dhe e shquan edhe si kryevepër apo kryedashuri ose dashuri mbi të gjitha dashuritë dhe pret e pret... derisa...

V

Në ciklin e pestë “ËNDËRR E PAARRITSHME” janë mbarështuar nëntë poezi, në të cilat poeti shfaq ndjenjat e tij të zjarrta, shpërfaq kujtimet e pashlyera, vëren dhe përjeton shumëçka nga jeta, njeh dhe ndjen nga afër përjetime të shumta dhe të ndryshme që marrin rrjedhën e tyre të përditshme. Vepra “QIRINJ PËR DRITË” e Fejzë Demirit është edhe një dëshmi bindëse e këtij krijuesi letrar, i cili nga vepra në vepër, gjithnjë e më shumë po e dëshmon veten se kësaj veprimtarie iu ka qasur me një përkushtim të duhur. Këtë pohim e mbështesim me të arriturat e këtij krijuesi, i cili prurjet e tij letrare në këtë vepër janë më të qëndrueshme dhe më të begata, gjë që shpresojmë se edhe në të ardhmen rezultatet e tij do të na gëzojnë edhe më shumë dhe më bindshëm.

Prishtinë, 20.2.2017

Sabit Jaha

Fjala e recensentit

GËRSHETIM NDJENJASH TË TË RINJVE

(Fejzë Demiri “Qirinj për dritë”, poezi, SAS, Prishtinë, 2017)

Dorëshkrimi i përmbledhjes poetike “Qirinj për dritë” i autorit Fejzë Demiri është dëshmia e pestë me radhë që jep të kuptohet se kemi të bëjmë me një krijues, i cili falë vullnetit dhe përkushtimit të tij inventiv, ofron krijime të arrira letrare, ku vargjet e lira lidhin çaste a momente të nduarduarta të jetës në përgjithësi. Dorëshkrimi i autorit, që pretendon a synon të bëhet libër, është strukturuar në pesë cikle: “Qirinj për dritë”, “Porta e zemrës”, “Lot shiu”, “Do të duhemi” dhe “Ëndërr e paarritshme”, të cilëve iu paraprinë poezia “Nuk është veçse të pëlqeja”. Që në poezinë paraprijëse kur poeti thotë: “Errësirën jam munduar të ta bëj dritë” ai e përmbyll me vargun e fundit: “Përgjithmonë e memorizuar në kujtesë”. Pra, poeti i tëri është ai që bën përpjekje të pareshtura për t’i thënë gjithë ato që ndjen për të dashurën – për personin që shkrihet si qiriri për dritë, që zgjon ndjenjat tek të rinjtë, të dashuruarit. Në ciklin e parë “Qirinj për dritë” poeti veneron lotin ngase “Edhe zemrës i vjen gjynah për lotin” sepse ai thotë “Unë jam hija jote” sepse “Ti je diell për mua” edhe pse Ai...apo Ajo... është “Në këtë natë pa gjumë”. Ja, kështu vargëzohen vargjet e poetit për synimet, dëshirat apo pretendimet e dy të rinjve, të cilët i mban apo i ushqen dashuria e ndërsjellë.

II

Në ciklin e dytë “Porta e zemrës” poeti para lexuesve shfaq ndjenjat e të riut (të resë) duke shpërthyer me një sërë vargjesh, që bëjnë fjalë për jetën, të shijuarit e saj, duke porositur: “Kurdo që e ndien veten të vetmuar/ Mund të hapësh portën e zemrës sime/ Aty ende ka vend për hyrjedaljet”, ngase “Ta kam dashuruar qenien/ Deri në ekstazë...” Dhe poeti thotë: “Sa keq që dhembjen nuk mund ta përshkruajnë fjalët/ Sa keq që fjalët nuk përshkruajnë dhembjen”, prandaj “Në këtë kaos dhimbjesh/ Unë, imazhi yt/ Në këtë kohë pa kohë/ Më ka marrë malli... / Përgjithmonë do të jem/ Unë, hiri yt/ Në pikë të dimrit më sjell vapën/ sepse thotë poeti: “Isha shekull/ U bëra dekadë/ Vit/ Muaj, / Javë/ Por, më së tepërmi, po më merr malli/ Për një çast/” Dhe, porta e zemrës është e hapur për dy veta, për njëri-tjetrin që duan të jenë përherë së bashku, si një trup i vetëm.

III

Në ciklin e tretë “Lot i shiut” janë përfshirë një tufë poezish, në të cilat poeti thotë: “Isha lot i shiut/ Shiu u bë lumë/ E lumi det/ Po aty/ Ku unë ruaj kujtimet”. Dhe te poezia “Buzët e tua” rrjedhin vargjet:” Të vetmet që larguakan/ Këtë vuajtje dhembjemadhe”, sikur na ripërtërihen vargjet edhe të sa e sa poetëve pararendës, që për motiv kanë pasur temën e dashurisë, atë të madhërishtes që i bën të dashuruarit të jenë edhe më të dashuruar në mes vete. Sepse, siç thotë poeti: “Kur e prek gacën e ndezur/ Ashtu është edhe dashuria/ Kjo flakëkuqe që përvëlton shpirtin”. Prandaj, “Më prit!”- thotë poeti. Në poezinë “Qielli im i yjzuar” poeti shprehet me afsh të zjarrtë: “Kur të pashë ty yjësi/ U mbusha me yje/ Yjzuan dritat..” nga qirinjtë e ndezur për dritë, për një yjësi, që pafundësisht, ngase një “Dritëlargësi e ndjeshme më lë pa frymë”. Prandaj, “Eja shiko në sirtarin tim/ Aty mbaj parfumin e dashurisë”.

IV

Në ciklin e katërt “Do të duhemi” mbarështohen një tubëz poezish, që për temë trajtojnë motivin e dashurisë. Ky cikël nis me poezinë po me të njëjtin titull “Do të duhemi” që përpjesëtimisht janë në raporte të njëjta, si njëra ashtu edhe tjetra gjini, të cilat i bashkon një qëllim i vetëm i sinqertë dhe i ndershëm- dashuria e ndërsjellë e tyre. Në vargjet e poetit: “Ne prapë do të duhemi...” nxjerr në pah mesazhin e të dashurit ndaj të dashurës apo anasjelltas që dashuria të jetë e përjetshme, e patjetërsueshme me qëllim që Njeriu ta do Njeriun, që di, njeh, ndjen dashurinë e çiltër. Prandaj, fuqiplot del vargu: “Do të thoja: ende s’jam ngopur unë me ty!” Dhe, “Do t’i fikja të gjitha dritat/ E do të qëndroja në errësirë.. / Se më as drita s’do të ketë kuptim pa ty/ “ Po, cila është kryevepër për poetin, i cili thotë: “ Kujtimi për ty do të kishte mbetur/ Si një kryevepër.” Kjo mbase vetvetiu nënkuptohet nga rrjedha e vargjeve që bartin mesazhin e vetë poezisë, e cila e mban dhe e bën për vete edhe lexuesin e vëmendshëm. Por poeti, assesi nuk jepet por pret një çast, një ditë dhe thotë: “Të pres, takohemi tek vendi/ Aty, ku i çmenduri mund çmendurinë,” pra atë ekstazën që mund ta përjetojnë vetëm të dashuruarit.

V

Në ciklin e pestë “Ëndrrat e paarritshme” vijnë poezitë e radhës, ku poeti shpreh ndjenjat e tij ndaj të dashurës, të bukurës, së cilës i drejtohet, pa mëdyshje: “Kur ti vetë u bërë/ zjarrndezëse për mua/ Atëherë si të mos bëhem unë / zjarrdashës për ty.” Dhe “Shiu largoi dëborën / E zemrën e ngrirë/ S’e shkriu.” Prandaj, “Rimendo para se të flasësh,” sepse “Koha luante symbyllas...” Dhe “Më lejo të lutem/ Gjumi yt të bëhem.” Prandaj “Do të takohemi sërish/ E kohës le t’i kthehemi pa fjalë” Dhe, krejt në fund “Edhe ëndrrën zgjoje/ Nga gjumi!”

Vargjet e përmbledhjes “Qirinjtë për dritë” të autorit të ri, i cili po ecën me hapa të matur dhe të sigurt, gjejmë një numër të konsideruar poezish, që në vetvete ngërthejnë temën e dashurisë, ashtu siç e dëshirojnë dhe e përjetojnë të rinjtë, moshatarë të poetit, i cili me mjaft përkushtim

i është qasur artit të bukur të fjalës. Prandaj fjalët e tij në vargje shprehin motivin e dashurisë në kohë dhe hapësirë, ku marrin shumëçka të rinjtë e të rejtat e kësaj moshe të ndjeshme. Prandaj, vargjet e tij janë tërheqëse dhe magjepsëse për të gjithë ata që dinë dhe duan të dinë edhe më shumë për dashurinë.

Prishtinë, 22.02.2017

Islam Rahimi